



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Diskutimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 1-19 korrik 2019.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fideli Ylli, Musa Ulqini, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Adelina Rista, Bujar Çela, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa dhe Selami Jenishehri.

Mungojnë:

Vilma Bello, Almira Xhembulla, Enada Kapllani dhe Klajdi Qama.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Përshëndetje!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së Komisionit!

Sot, në rend të ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 10 qershor 2019.

A ka ndonjë diskutim në lidhje me procesverbalin? Nuk ka.

Kalojmë në miratimin e tij.

Kush është dakord?

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës është diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së komisionit për përdhën 1 deri në 19 korrik 2019.

Për ditën e premte, datë 15 korrik 2019, është parashikuar të kalojmë në diskutimin në parim të projektligjit “Për rininë”, që është propozim i Këshillit të Ministrave.

Si mendoni? Po, zonja Ekonomi.

Milva Ekonomi – Unë doja t’ju vija në dijeni se kemi një kalendar, që detyrohet nga veprimtaria e Kuvendit dhe, duke u nisur nga ky fakt, duhet të shohim të gjithë veprimtarinë tonë, që të jemi të gatshëm të çojmë në Kuvend në datën 11 korrik ligjin “Për rininë”, për të cilin komisioni ynë është përgjegjës.

E dyta, kemi qenë në komunikim me Këshillin e Ministrave lidhur me projektligjin “Për Akademinë e Shkencave”. Përgjigja e Këshillit të Ministrave ka ardhur, kështu që do të donim të merrnim mendimin edhe të këshilltarit tonë juridik, me qëllim që të na japë një opinion për përgjigjen e Këshillit të Ministrave.

Së treti, në komisionin tonë janë grumbulluar të gjitha CV-të për plotësimin e 3 vendeve vakant për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së. Edhe për ata duhet të bëjmë dëgjese, që të referojnë pse kanë zgjedhur të jenë në Këshillin Drejtues të RTSH-së. Ne do të bëjmë pyetjet tona, pastaj do të fillojë procedura brenda komisionit. Unë mendoj që të gjitha këto veprime duhen kryer brenda muajit korrik, ndaj është parashikuar edhe ky kalendar. Ditën e premte në orën 10:00 është lënë dëgjesa për diskutimin në parim të ligjit për rininë, me sa kemi rënë dakord në sekretari, pra, kryetarja, unë dhe sekretari. Unë e kuptoj se e premtja është një ditë që ne ia dedikojmë terrenit, por këtë javë e kemi tejkaluar detyrën me terrenin, kështu që mendoj se duhet të mbledhemi të diskutojmë projektligjin në parim. Sekretaria e komisionit tonë të komunikojë me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, që të kemi këtu përfaqësues të lartë të ministrisë, mundësisht ministren, që të bëjë një prezantim.

Unë e di që ky projektligj është duke u diskutuar edhe në komisionet e tjera, prandaj do t’i lutesha shumë sekretarisë, që, përpara se të bjerë dakord edhe me ministrinë, të shohë edhe

kalendarët e komisioneve të tjera për këtë ligj. Gjithashtu, është bërë një plan dëgjësash që lidhen edhe me grupet e interesit, edhe me ata që kanë paraqitur kërkesë te ne. Të mos harrojmë se kemi një kërkesë të CRCA-së, të shoqatës së Altin Azizaj, e cila është e depozituar prej kohësh në komisionin tonë dhe ne kemi kthyer përgjigje që, kur të vijë diskutimi për këtë projektligj, do ta kemi në konsideratë.

Fatjona Dhimitri – Lidhur me dëgjesat: parashikohet për dëgjesë Këshilli Studentor i UT-së, Akademia e Studimeve Politike, Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, CRCA, Koalicioni për Arsimin në Shqipëri, Aleanca Gjinore për Zhvillim, Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Shoqëria e Jetimëve të Shqipërisë. Propozojmë të jetë e pranishme ADRA, të paktën nga ana ime, ku folës do të jetë Kristi Qendro.

Milva Ekonomi – Zonja kryetare, përpara se të propozoni, ata duhet të regjistrohen në sitin e parlamentit, sepse, nëse nuk janë...

Fatjona Dhimitri – Janë të regjistruar, se i kam parë.

Milva Ekonomi – Ne parashikojmë kohën dhe u themi që nuk kanë më shumë se 10-15 minuta kohë për të folur.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, do të jenë: Qendra e të Drejtave të Fëmijëve CRCA, Koalicioni për Arsimin në Shqipëri, Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri, Shoqata ADRA, Aleanca Gjinore për Zhvillim, Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Shoqëria e Jetimëve të Shqipërisë. Mirë është që t'i dëgjojmë të gjitha shoqatat lidhur me propozimet që mund të kenë për projektligjin "Për rininë". Gjithashtu, është dhe Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë.

Ismet Beqiraj – Mund të bëhen nja 50 shoqata.

Fatjona Dhimitri – Ne po përzgjedhim ato shoqata që mund të japin një mendim të posaçëm lidhur me projektligjin.

Ismet Beqiraj – Në radhë të parë, ka një praktikë, siç e tha edhe kryetarja. Nëse janë të regjistruar te siti i parlamentit, të marrë pjesë kushdo.

E dyta, duhet parë nëse mendimet e tyre për nene të veçanta i kanë sjellë me shkresë. Sigurisht që do t'i marrim në konsideratë, por do të rrimë çdo javë me dëgjesa.

Fatjona Dhimitri – Pikërisht këtë po thosha edhe unë, që janë shoqata të regjistruara në sitin e Kuvendit, të paktën për atë që janë kontrolluar, pra Shoqata ADRA dhe Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri, veç CRCA-së dhe Koalicionit për Arsimin në Shqipëri, që janë parashikuar edhe nga pala juaj. Do t'ua japim mundësinë edhe shoqatave, që kanë kërkuar të jenë të pranishme për t'u dëgjuar, siç thatë dhe ju, zoti Beqiraj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që me shkrim.

Të gjitha parashtrimet lidhur me seancën dëgjimore i hedhim në votim, bashkë me dy shoqatat e tjera të propozuara prej meje, Shoqatën ADRA dhe Rrjetin Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri.

Kush është dakord?

Miratoheh.

Milva Ekonomi – Gjëja tjetër që duhet të kemi parasysh është që, përpara se të fillojë diskutimi i ligjit, duhet të zgjedhim relatorin dhe duhet të kemi parasysh që të martën në mesditë relacioni duhet të jetë gati për depozitim. Kështu që veprimtaritë tona për të premtën, të hënën dhe të martën duhet të jenë intensive, prandaj dhe Ismeti bën thirrje që kush i ka gjërat me shkrim, t'i depozitojë. I lutem sekretarisë që t'u bëjë thirrje!

Kë mendoni të caktojmë si relator?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Almirën? Më të renë e komisionit?

A është dakord grupi? Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pikërisht këtë thamë, që të gjitha propozimet për seanca dëgjimore do t'i paraqiten sekretarisë së komisionit me shkrim.

Ismet Beqiraj – Zonja kryetare, po ndërhyj edhe një herë. Meqenëse ky ligj ka hyrë në procedurë për datën 11, duke bërë edhe një analogji me ligjin “Për trajtimin financiar”, që sapo kaluam, pati palë të interesuara, madje sindikata, shoqata të naftës, të minatorëve dhe, meqenëse kishte procedurën, ata i depozituan me shkrim të gjitha propozimet e tyre. Të njëjtën gjë do të bëjnë edhe këta që do të vijnë, thjesht do të na kursejnë kohën, se në të gjithë praktikën e ndjekur deri tani, të gjitha propozimet janë grumbulluar dhe, rast pas rasti, janë pasqyruar edhe kur i kemi diskutuar nen për nen. Ndaj, mua më duket harxhim i kotë kohe, duke u marrë me një listë të gjatë me dëgjues.

Fatjona Dhimitri – Secili nga përfaqësuesit e shoqatave do të ketë minutazhin e përcaktuar dhe nuk besoj se do të jetë harxhim kohe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Ramë dakord për listën dhe për kohën që do t'i japim çdo shoqate. Mendoj të kalojmë te çështja tjetër.

Fatjona Dhimitri - Kalojmë te kandidaturat.

Mendoj që parashikimet e kandidaturave të mos i kemi në fokus sot, pasi besoj se herën tjetër opozita do të ketë më tepër specifikime për to.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po flasim për parashtrimin e emrave dhe për CV-të e tyre.

Milva Ekonomi – Po ju vë në dijeni se si zgjidhen kandidaturat.

Kemi një ligj për Radiotelevizionin Shqiptar, në bazë të të cilit ky televizion funksionon duke pasur një kryetar, një këshill drejtues dhe një drejtor ekzekutiv, të cilët kanë detyra specifike. Kur u bë ky ligj, kandidaturat u vendosën nga të dyja palët në komision dhe kanë mandat terminal: fillon në një datë dhe mbaron në një tjetër. Kur mbaron koha e mandatit, për sa kohë që komisioni ynë nuk e ka zgjidhur ende kandidatin zëvendësues, vazhdon të qëndrojë në detyrë ai që është. Për çdo vend vakant, kur mbaron koha, nga komisioni ynë shpallet vakanca dhe duhet të vijë minimalisht 4 propozime me 4 kandidatë, të cilët kërkojnë të marrin atë vend.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Njerëz të ndryshëm, që vijnë nëpërmjet shoqatave.

Kjo listë është shpallur disa herë. Ne kemi listën dhe vendet janë të caktuara: PS-PD, PS-PD. Ne nuk kemi mundësi të lëvizim numrin e atyre që kemi në komision. Lista e PD-së është zgjedhur nga paraardhësit tuaj, por në momentin kur do të miratohej në Kuvend, opozita hoqi dorë nga mandatet. Atëherë, kryetari i shumicës tonë parlamentare, zoti Balla, thotë: “Për sa kohë që kjo opozitë hoqi dorë nga mandatet, duhet t’i lëmë të drejtën opozitës zëvendësuese të marrë vendim për ata që do të jenë në Këshillin Drejtues”. Ju ose do të hapni procesin, ose do të shikoni listat dhe të vendosni, sepse kështu është situata. Kandidatët e tjerë i takojnë Partisë Socialiste, ndaj kjo situatë duhet zgjidhur.

Fatjona Dhimitri – Jam në dijeni, zonja nënkryetare.

Besoj se herën tjetër do t’u sjellim të gjitha parashtrimet e opozitës për plotësimin e vakancave për kandidaturat.

Milva Ekonomi– E kuptoj.

Ne ramë dakord për këto gjëra.

Fatjona Dhimitri – Për kandidaturat do ta lëmë herën tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Besoj se sot kemi edhe diçka tjetër, por nuk e di si do të veprojmë, sepse për ligjin e Akademisë së Shkencave është depozituar një letër nga Këshilli i Ministrave. E kemi këtu për ta lexuar, por për sa kohë që ne ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kemi këtu. Ariana ka qenë e kujdesshme dhe e ka bërë gati, si përherë. Ndërkohë, këshilltari ynë juridik duhet ta lexojë para se ne të vendosim për kalendarin e veprimtarisë dhe për kthimin e përgjigjes ndaj Këshillit të Ministrave.

Fatjona Dhimitri – Do të thosha të njëjtën gjë.

Pra, mendoj që shqyrtimin e letrës së Këshillit të Ministrave ta lëmë për një moment tjetër dhe më pas të procedojmë për seancat dëgjimore. Sipas ligjit, të merret mendimi i të dyja palëve.

A keni diçka tjetër për të shtuar për kalendarin e punës? Urdhëroni!

Ismet Beqiraj – Si relator i projektligjit, të cilin ne si grup nismëtar i deputetëve po e diskutojmë prej gati një muaj e gjysmë, mendoj se është mirë të përcaktojmë që sot seancat dëgjimore dhe t’i mundësojmë brenda muajit korrik, ashtu sikurse po ndodh me ligjin “Për rininë”, i cili, gjithashtu, ka pasur një diskutim të gjerë, gati mbi 1 vit. Pra, nuk ka arsye pse të mos hartojmë kalendarin për dëgjesa, sepse nuk na kushton asgjë. Të mos presim të mblidhemi sërish, por ta përgatisim tani. Shikoj që është marrë një nismë; kemi edhe përgjigje nga Këshilli i Ministrave, pra le t’i planifikojmë...

Fatjona Dhimitri – Ismet, të lexohet përgjigja nga të dyja palët, ta shqyrtojmë me grupet tona parlamentare dhe më pas të vendosim. Sot nuk do të caktojmë asgjë. Mendoj të biem dakord.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, zonja kryetare!

Ju nuk mund të thoni se nuk caktoni asgjë, sepse unë jam deputet, bëj kërkesë dhe duhet ta hedhim në votim. Mos thoni: “e caktoj unë”, sepse e votojmë ne.

Fatjona Dhimitri – Ismet, nëse do ta caktoja unë, atëherë që nga pika a, do të kërkoja praninë e ministrit mbledhjen e shkuar. E kupton? Këtu vjen Skënder Gjinushi, paraqitet si ekspert i projektligjit, ndërkohë që është hartuesi i vërtetë i tij.

Ismet Beqiraj – Zonja kryetare, ju lutem, mos paragjykoni!

Fatjona Dhimitri – Jo, nuk po paragjykoj. Po flas për dezinformimin që u bë herën e kaluar.

Ismet Beqiraj – Kushdo që ka paragjykim në kokë, e pengon çështjen.

Ju lutem, nuk kam emra. Projektligjin e ka propozuar një grup i nderuar deputetësh.

Fatjona Dhimitri – Një grup fantazmë, të themi të vërtetën.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, mos ndërhyini kur flas unë! Respekto rregullat!

Fatjona Dhimitri – Zoti Ismet, këtu jam unë kryetare!

Ismet Beqiraj – Le të jesh kryetare! Qofsh shëndosh!

Fatjona Dhimitri – Po ju them që nuk do të trajtohet në këto momente.

Ismet Beqiraj – Ju lutem, mos ndërhyini kur unë jap një mendim! Jepni mendimin tuaj kur të mbaroj unë! Po flas për procedurë.

Ka një muaj e gjysmë që ka filluar dhe nuk duhet t’i paragjykojmë gjërat. Unë nuk jam caktuar kot si relator. Gjithashtu, edhe si anëtar i këtij komisioni kërkoj të vijojë procedura

korrekte si për të gjitha ligjet e tjera. Këtu nuk e vendosim unë apo ti, por e vendos komisioni me votë, sipas Rregullores.

Fatjona Dhimitri – Çfarë do të vendosim me votë? Letra ka ardhur dje.

Ismet Beqiraj – Ja çfarë do të vendosim.

Fatjona Dhimitri – Zoti Ismet, ju lutem, të mos fillojmë me manipulimet e bëra që nga momenti i zgjedhjeve deri në momentin e hartimit të projektligjit!

Ismet Beqiraj – Ju lutem!

Unë propozoj që ne sot të përcaktojmë kalendarin e veprimtarisë së komisionit nga dita e sotme deri në fund të këtij sesi.

Fatjona Dhimitri – Dakord.

Kërko mbledhjen me kuorumin e sotëm për të hartuar dhe për të miratuar edhe një herë kalendarin e punës për Akademinë e Shkencave dhe më pas të vijojmë me dëgjuesat.

Ismet Beqiraj – Mos u kap me fjalët! Ç’do të thotë: “e vendos unë”. As unë nuk e vendos, as ti. E vendos Rregullorja dhe votimi.

Milva Ekonomi – Mund ta marr fjalën, ju lutem?

Fatjona Dhimitri – Po, mund të flisni.

Milva Ekonomi – Zoti Ismet, keni të drejtë. Ne duhet të përshpejtojmë punën për këtë projektligj, por para se të fillojmë të mendojmë për kalendarin, gjykoj se është mirë të lexojmë letrën që ka sjellë Këshilli i Ministrave, sepse edhe nga pikëpamja ligjore ka nevojë të mbahen parasysh shënimet e tyre për këtë projektligj. Besoj se asnjë nga ne nuk është gati të thotë diçka për kalendarin pa e lexuar letrën, kështu që ta marrim letrën me vete, ta lexojmë dhe kalendarin mund ta vendosim nesër në Kuvend, sepse nuk ka ndonjë gjë të jashtëzakonshme për të bërë. Duhet të shikojmë përgjigjen që ka ardhur nga Këshilli i Ministrave dhe më pas të gjykojmë. Kuorumin e bëjmë edhe me 9 vetë.

Po ashtu, zonja kryetare, do t’ju lutesha të mos i paragjykoni nismat e deputetëve, sepse janë shumë të rëndësishme. Nëse një nismë ligjore ka ardhur me 15 firma, duke marrë në konsideratë edhe grupin e ekspertëve për ta paraqitur, kjo është e drejtë që ua jep Kushtetuta dhe Rregullorja dhe ne, si komision, nuk mund të marrim përsipër të themi nëse kanë apo nuk kanë të drejtë. Kjo është shumë e rëndësishme.

E dyta, ne vepruam siç kërkon Rregullorja, që një projektligj, i cili ka angazhime financiare, të mos gjykohet nga ky komision pa dhënë përgjigje Këshilli i Ministrave. Këshilli i Ministrave ka dhënë përgjigje, ndaj po kërkojmë ta shtyjmë kalendarin, sepse kemi marrë një përgjigje të kualifikuar. Nuk mund të paragjykojmë: bënë apo nuk bënë mirë. Ne duhet të mbështetemi te ligjet, te rregulloret, tek ato që na japin mandatin për të vepruar në komision.

Për shembull, unë do të thosha se duhet ta shikojmë me kujdes këtë letër dhe më pas të mendojmë se si do ta bëjmë kalendarin.

Fatjona Dhimitri – Atëherë, ditën e premte, kur të kemi prezantimin e projektligjit “Për rininë”, si dhe seancat dëgjimore, mendoj që në fund të mbledhjes të diskutojmë procedurën e mëtejshme për dëgjesën e Akademisë së Shkencave. Dakord?

Mund t’ju kërkoj të flasim pak me sekretarinë? A ka letra të tjera të ardhura për komisionin tonë?

(Diskutime pa mikrofon.)

Adelina Rista – A mund të them dy fjalë për dëgjesën e projektligjit “Për rininë”?

Meqenëse kemi disa grupe interesi që do të vijnë për dëgjesë, është mirë që ne më parë të kemi mendimet e tyre të detajuara me shkrim, me qëllim që në dëgjesë, nëse atyre u lëmë 5 minuta kohë, nuk duhet të flasin asnjë minutë më tepër, kështu që ne t’i studiojmë më parë të gjitha mendimet e tyre dhe jo t’i dëgjojmë *live* në ato momente. Në komision ata do të kenë mundësi të shprehen shkurt, për të qenë eficient në kohë dhe në mendim.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zonja Adelina!

Të njëjtën gjë parashtrova edhe unë më parë, që të gjitha mendimet dhe propozimet e tyre për projektligjin të depozitohen me shkrim pranë sekretarisë së komisionit, por mendoj se minutazhi prej 5 minutash për ta është i pamjaftueshëm. Duhet të paktën 10 minuta, sepse vetëm prezantimi shkon disa minuta. Faleminderit!

Nëse nuk kemi gjë tjetër për të shtuar, ju falenderoj për pjesëmarrjen në komision!

MBYLLET MBLEDHJA